



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. 1414 Prot

Shkodër, më 21.1.2026

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin: “Për miratimin e projektit “Sunny Schools” , të financuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë – OSFA dhe Bashkia Shkodër, i cili përfshin instalimin e impianteve fotovoltaike në ndërtesat e shkollave 9-vjeçare publike “Ndre Mjeda”, “Salo Halili” dhe “Ndoc Mazi””.

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,

KRYETAR

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI
ZV. KRYETAR
Alban PREKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KRYETAR**

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë _____._____.2026

“PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT “SUNNY SCHOOLS”, TË FINANCUAR NGA FONDACIONI SHOQËRIA E HAPUR PËR SHQIPËRINË – OSFA DHE BASHKIA SHKODËR, I CILI PËRFSHIN INSTALIMIN E IMPIANTEVE FOTOVOLTAIKE NË NDËRTESAT E SHKOLLAVE 9-VJEÇARE PUBLIKE “NDRE MJEDA”, “SALO HALILI” DHE “NDOC MAZI”.

Këshilli i Bashkisë Shkodër sot me datë _____._____.2026, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; ligjit nr.87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026” ; Marrëveshjes së Bashkëpunimit me nr. 24895 Prot., datë 04.12.2025 ndërmjet Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë - OSFA dhe Bashkisë Shkodër; VKB nr. 84 datë 18.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër”, pas shqyrtimit të relacionit nr. _____ prot., datë _____ të administratës së Bashkisë Shkodër, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1. Të miratohet projekti “Sunny Schools”, i financuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) dhe Bashkia Shkodër, i cili përfshin instalimin e impianteve fotovoltaike në ndërtesat e shkollave 9-vjeçare publike “Ndre Mjeda”, “Salo Halili”, sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr. 24895 Prot., datë 04.12.2025.
2. Vlera e financimit nga Fondacioni OSFA është 21,120 euro për instalimin e impianteve fotovoltaike në ndërtesat e shkollave 9-vjeçare publike “Ndre Mjeda” dhe “Salo Halili”, e konvertuar në lek, në vlerë 2,040,825.6 lekë, me kursin e këmbimit të datës 4.12.2025, kur është lidhur marrëveshja. Zbatimi i projektit dhe buxhetit do të realizohet nga Fondacioni OSFA, i cili do të menaxhojë procedurat e prokurimit dhe kontraktimin e subjekteve të treta për instalimin e impianteve, në përputhje me standardet teknike të kërkuara.

3. Bashkia Shkodër do të financojë me fondet e veta instalimin e impiantit fotovoltaiik në ndërtesën e shkollës 9-vjeçare publike “Ndoc Mazi”, në shumën totale 1,662,690 lekë i parashikuar në programin buxhetor AI141 Arsimi, në fishën e buxhetit P.AI141.Q1.O3.A7, ku 1,566,728 lekë në artikull 231 - Shpenzime kapitale të trupëzuara dhe 95,962 lekë në artikull 230 - Shpenzime kapitale të patrupëzuara, me institucion likuidues Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike (DPMOP), e cila do të përballohet përmes rialokimit të fondeve të trashëguara të vitit 2025, sipas fishes bashkëngjitur.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/KRYETAR
Alban PREKA

Zv. Kryetar

Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit

Financiar

ELVIN BEAHIMI

Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor

Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së
Objekteve Publike

Geza Kulla

Drejtoria e Arsimit

Donatela Kola

Drejtoria e Përgjithshme Juridike,
Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve
Mbështetëse

Drejtoria Juridike

Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të
Qendrueshëm Ekonomik

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe
Përmirësimit të Klimës së Biznesit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË QENDRUESHËM EKONOMIK

Nr _____ prot.

Shkodër, me _____.2025

RELACION

“PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT “SUNNY SCHOOLS” , TË FINANCUAR NGA FONDACIONI SHOQËRIA E HAPUR PËR SHQIPËRINË – OSFA DHE BASHKIA SHKODËR, I CILI PËRFSHIN INSTALIMIN E IMPIANTEVE FOTOVOLTAIKE NË NDËRTESAT E SHKOLLAVE 9-VJEÇARE PUBLIKE “NDRE MJEDA”, “SALO HALILI” DHE “NDOC MAZI”.

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia Shkodër ka aplikuar pranë Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) në kuadër të iniciativës “Sunny Schools”, duke propozuar përfshirjen e tre shkollave 9-vjeçare publike në territorin e saj.

Pas procesit të vlerësimit, Bashkia Shkodër është shpallur fituese e projektit “Sunny Schools” për periudhën 2025–2026, duke u vlerësuar për angazhimin institucional në fushën e energjisë së rinovueshme, përvojën e mëparshme në zbatimin e projekteve të ngjashme dhe gatishmërinë për bashkëfinancim. Ky projekt përbën një vazhdimësi të drejtpërdrejtë të politikave vendore të Bashkisë Shkodër në fushën e energjisë së qëndrueshme dhe zbatimin e Planit Vendor të Veprimit për Energjinë dhe Klimën.

Në kuadër të projektit “Sunny Schools” janë përzgjedhur tre shkolla 9-vjeçare publike, si më poshtë:

1. Shkolla 9-vjeçare “Ndre Mjeda”
2. Shkolla 9-vjeçare “Salo Halili”
3. Shkolla 9-vjeçare “Ndoc Mazi”

Të gjitha ndërtesat janë në pronësi dhe nën administrimin e Bashkisë Shkodër dhe plotësojnë kushtet teknike për instalimin e impianteve fotovoltaike në çati.

Emri i shkollës	Adresa	Lloji i shkollës	Sip. e përafërt e çatisë (m ²)	Zonë urbane/rurale	Viti i ndërtimit	Nr. i nxënësve
Ndre Mjeda	Rr. Kongresi i Lushnjës	Shkollë 9-vjeçare	651	urbane	1971-1989	696
Ndoc Mazi	Rr. Justin Godard	Shkollë 9-vjeçare	865	urbane	1945-1970	111
Salo Halili	Rr. Fetih Dizdari	Shkollë 9-vjeçare	1007	urbane	1945-1970	266

Zbatimi i projektit “Sunny Schools” do të realizohet mbi bazën e Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur ndërmjet Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë – OSFA dhe Bashkisë Shkodër me Nr. 24895 Prot., datë 04.12.2025.

Fondacioni OSFA angazhohet të financojë dhe menaxhojë drejtpërdrejt instalimin e impianteve fotovoltaike në dy shkolla, konkretisht shkolla “Ndre Mjeda” dhe shkolla “Salo Halili”. Vlera e financimit nga OSFA për këto dy shkolla është 21,120 euro, e konvertuar në lek, në vlerë 2,040,825.6 lekë, me kursin e këmbimit të datës 4.12.2025, kur është lidhur marrëveshja. Fondi do të menaxhohet nga vetë OSFA dhe nuk do të transferohet në llogaritë e Bashkisë Shkodër. OSFA do të realizojë identifikimin, prokurimin dhe kontraktimin e subjekteve të treta për instalimin e impianteve, duke garantuar standarde të larta teknike. Pas përfundimit të periudhës së projektit, impiantet do t’i kalojnë në pronësi Bashkisë Shkodër, ku Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike do të marrë në dorëzim dhe të kalojë në inventar investimin e kryer.

Në vijim të detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja e bashkëpunimit, Bashkia Shkodër merr përsipër angazhimin që brenda vitit 2026 të financojë me fondet e veta instalimin e impiantit fotovoltaike në Shkollën 9-vjeçare “Ndoc Mazi”, në shumën totale 1,662,690 lekë i parashikuar në programin buxhetor AI141 Arsimi, në fishën e buxhetit P.AI141.Q1.O3.A7 ‘Instalimi i impianteve fotovoltaike të shkollave 9-vjeçare publike’, ku 1,566,728 lekë në artikull 231 - Shpenzime kapitale të trupëzuara dhe 95,962 lekë në artikull 230 - Shpenzime kapitale të patrupëzuara, me institucion likuidues Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike (DPMOP), përmes rialokimit të fondeve të trashëguara të vitit 2025, sipas fishes bashkëngjitur; ndërsa dy shkollat e tjera “Ndre Mjeda” dhe “Salo Halili”, do të financohen nga OSFA.

Zbatimi i projektit “Sunny Schools” pritet të sjellë përfitime të shumta, ndër të cilat:

- Ulje e shpenzimeve për energjinë elektrike në institucionet arsimore;
- Rritje e përdorimit të energjisë së rinovueshme dhe reduktim i emetimeve të CO₂;

- Përmirësim i kushteve mjedisore dhe edukative për nxënësit dhe stafin pedagogjik;
- Ndërgjegjësim i komunitetit shkollor për çështjet e energjisë dhe ndryshimeve klimatike;
- Forcim i rolit të Bashkisë Shkodër si institucion lider në politikat lokale të qëndrueshmërisë.

Projekti “Sunny Schools” përfaqëson një investim të rëndësishëm për Bashkinë Shkodër, i cili kontribuon drejtpërdrejt në modernizimin e infrastrukturës arsimore, uljen e kostove buxhetore dhe përmbushjen e objektivave lokale dhe kombëtare për energjinë e rinovueshme.

Për këto arsye, kërkohet nga Këshilli Bashkiak miratimi i projektit “Sunny Schools”, në përputhje me marrëveshjen e bashkëpunimit të lidhur ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë – OSFA, sipas fishes bashkëngjitur.

K R Y E T A R

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI
ZV KRYETAR
Alban PREKA



Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Qendrueshëm Ekonomik

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit

Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike

P.AI141.Q1.O3.A7 Instalimi i impianteve fotovoltaike të shkollave 9-vjeçare publike “Ndre Mjeda”, “Salo Halili” dhe “Ndoc Mazi”

01. Person kontakti

Emri i propozuesit të projektit	Bashkia e Shkodrës	Firma e propozuesit të Projektit	
Të dhëna të detajuara për propozuesin e projektit	Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike		
Institucioni Buxhetor/ Ministria/grupi/sektori	Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	Vendodhja e Projektit	Bashka Shkodër

02. Identifikimi i Idesë së Investimit

Projekt Idea	Instalimi i impianteve fotovoltaike të shkollave 9-vjeçare publike “Ndre Mjeda”, “Salo Halili” dhe “Ndoc Mazi”
Problemet për tu adresuar	Bashkia Shkodër, në kuadër të politikave vendore për energjinë e qëndrueshme dhe zbatimin e Planit Vendor të Veprimit për Energjinë dhe Klimën, ka aplikuar pranë Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) në kuadër të iniciativës “Sunny Schools”. Pas procesit të vlerësimit, Bashkia Shkodër është shpallur fituese e projektit për periudhën 2025–2026, me përfshirjen e tre shkollave 9-vjeçare publike: Shkolla “Ndre Mjeda”, Shkolla “Salo Halili” dhe Shkolla “Ndoc Mazi”. Në bazë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Nr. 24895 Prot., datë 04.12.2025 ndërmjet OSFA dhe Bashkisë Shkodër, financimi dhe zbatimi i projektit realizohet në mënyrë të kombinuar, ku Fondacioni OSFA financoi dhe menaxhon drejtpërdrejt instalimin e impianteve fotovoltaike në shkollat “Ndre Mjeda” dhe “Salo Halili”, ndërsa Bashkia Shkodër merr përsipër financimin e instalimit të impiantit fotovoltaike në shkollën “Ndoc Mazi” me fondet e veta. ○ Vlera e financimit nga Fondacioni OSFA është 21,120 euro për instalimin e impianteve fotovoltaike në ndërtesat e shkollave 9-vjeçare publike “Ndre Mjeda” dhe “Salo Halili”, e konvertuar në lek, në vlerë 2,040,825.6 lekë, me kursin e këmbimit të datës 4.12.2025, kur është lidhur marrëveshja. Zbatimi i projektit dhe buxhetit do të realizohet nga Fondacioni OSFA, i cili do të menaxhojë procedurat e prokurimit dhe kontraktimin e subjekteve të treta për instalimin e impianteve, në përputhje me standardet teknike të kërkuara. ○ Bashkia Shkodër do të financojë me fondet e veta instalimin e impiantit fotovoltaike në ndërtesën e shkollës 9-vjeçare publike “Ndoc Mazi”, në shumën totale 1,662,690 lekë i parashikuar në programin buxhetor AI141 Arsimi, në fishën e buxhetit P.AI141.Q1.O3.A7 ‘Instalimi i impianteve fotovoltaike të shkollave 9-vjeçare publike’, ku 1,566,728 lekë në artikull 231 - Shpenzime kapitale të trupëzuara dhe 95,962 lekë në artikull 230 - Shpenzime kapitale të patrupëzuara, me institucion likuidues Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike (DPMOP), e cila do të përballohet përmes rialokimit të fondeve të

	trashëguara të vitit 2025.														
	Kohëzgjatja e kontratës është deri më 31.12.2026. Pas përfundimit të periudhës së projektit, impiantet do t'i kalojnë në pronësi Bashkisë Shkodër, ku Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike do të marrë në dorëzim dhe të kalojë në inventar investimin e kryer.														
Emri i Programit	Arsimi - Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar.														
Qëllimet dhe objektivat e Programit të cilat projekti do të ndihmojë të arrihen	Synimi i projektit “Sunny Schools” është rritja e përdorimit të energjisë së rinovueshme në institucionet arsimore publike, ulja e shpenzimeve për energjinë elektrike dhe reduktimi i ndikimit mjedisor, duke kontribuar njëkohësisht në përmirësimin e kushteve edukative dhe në forcimin e rolit të Bashkisë Shkodër si institucion lider në politikat lokale të qëndrueshmërisë dhe tranzicionit energjetik. Objektivat: • Instalimi dhe vënia në funksion e impianteve fotovoltaike në tre shkolla 9-vjeçare publike; • Ulje e kostove të energjisë elektrike për institucionet arsimore përfituese; • Rritje e përdorimit të energjisë së rinovueshme dhe reduktim i emetimeve të CO₂; • Forcimi i rolit të Bashkisë Shkodër në zbatimin e politikave lokale për energjinë e qëndrueshme. • Ndërgjegjësim i komunitetit në tërësi.														
03. Kostot e Projektit të Investimit															
	<table><tr><th>Totali</th><th>Viti 2026</th></tr><tr><td>A.1 Instalimi i impianteve fotovoltaike shkolla 9-vjeçare publike “Ndre Mjeda” (donatori)</td><td>2,040,825.6</td></tr><tr><td>A.2 Instalimi i impianteve fotovoltaike shkolla 9-vjeçare publike “Salo Halili” (donatori)</td><td></td></tr><tr><td>Totali i Projektit i financuar nga OSFA (donator)</td><td>2,040,825.6</td></tr><tr><td>A.3 Instalimi i impianteve fotovoltaike, shkolla 9-vjeçare publike “Ndoc Mazi”(fondet e veta)</td><td>1,662,690</td></tr><tr><td>A.3.1 Projektimi i punimeve (fondet e veta)</td><td>95,962</td></tr><tr><td>A.3.2 Zbatimi i punimeve (fondet e veta)</td><td>1,500,000</td></tr></table>	Totali	Viti 2026	A.1 Instalimi i impianteve fotovoltaike shkolla 9-vjeçare publike “Ndre Mjeda” (donatori)	2,040,825.6	A.2 Instalimi i impianteve fotovoltaike shkolla 9-vjeçare publike “Salo Halili” (donatori)		Totali i Projektit i financuar nga OSFA (donator)	2,040,825.6	A.3 Instalimi i impianteve fotovoltaike, shkolla 9-vjeçare publike “Ndoc Mazi”(fondet e veta)	1,662,690	A.3.1 Projektimi i punimeve (fondet e veta)	95,962	A.3.2 Zbatimi i punimeve (fondet e veta)	1,500,000
Totali	Viti 2026														
A.1 Instalimi i impianteve fotovoltaike shkolla 9-vjeçare publike “Ndre Mjeda” (donatori)	2,040,825.6														
A.2 Instalimi i impianteve fotovoltaike shkolla 9-vjeçare publike “Salo Halili” (donatori)															
Totali i Projektit i financuar nga OSFA (donator)	2,040,825.6														
A.3 Instalimi i impianteve fotovoltaike, shkolla 9-vjeçare publike “Ndoc Mazi”(fondet e veta)	1,662,690														
A.3.1 Projektimi i punimeve (fondet e veta)	95,962														
A.3.2 Zbatimi i punimeve (fondet e veta)	1,500,000														

A.3.3 Mbikqyrja e punimeve (fondet e veta)	53,978	53,978
A.3.4 Kolaudimi i punimeve (fondet e veta)	12,750	12,750
Totali i Projektit i financiar nga Bashkia Shkodër	1,662,690	1,662,690
04. Autorizuesit / Hapat e aprovimit të projekt idesë		
Drejtuesi i Programit ne Institucionin Buxhetor (IB)	Institucioni likuidues: Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	
Komente nga Drejtuesi i Programit		
Sekretari i Përgjithshëm		
Komente nga Sekretari i Përgjithshëm (nqs ka)		